

20240210573

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J I PËRDORIMIT TË GJUHËS MAQEDONASE

Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohet përdorimi i gjuhës maqedonase, i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjuhë zyrtare, në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, themelimi i Këshillit për përdorimin e gjuhës së standardizuar maqedonase dhe kompetencat e tij, mbikëqyrja mbi zbatimin e këtij ligji dhe çështje tjera me rëndësi për përdorimin e gjuhës maqedonase.

(2) Përdorimi i gjuhës maqedonase si gjuhë zyrtare është e drejtë dhe detyrë e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Përdorimi i gjuhës maqedonase si gjuhë zyrtare në marrëdhëniet ndërkombëtare, është e drejtë dhe detyrë e çdo përfaqësuesi të shtetit dhe pushtetit lokal.

(4) Gjuha maqedonase është trashëgimi jomateriale kulturore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Republika), në pajtim me ligj.

Neni 2

(1) Gjuha maqedonase, në kuptim të këtij ligji, është gjuha standarde maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik.

(2) Përdorimi i gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, në kuptimin e këtij ligji, përfshin zbatimin e tij, mbrojtjen, avancimin dhe pasurimin.

Neni 3

(1) Me këtë ligj nuk kufizohen e drejta për krijimtari të lirë dhe zhvillimi i identitetit gjuhësor dhe kulturor të qytetarëve që i përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikë.

(2) Me këtë ligj nuk kufizohet përdorimi i të folurit të lirë (gjuha dialektore, gjuha e bisedës etj) në krijimtarinë artistike e të gjitha llojeve.

Neni 4

(1) Zbatimi, mbrojtja, avancimi dhe pasurimi i gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik përfshinë, sidomos:

1. përdorimin e drejtë të gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetit të saj në procesin e edukimit dhe në të gjitha shkallët e arsimit;

2. përdorimi dhe shqiptimi i drejtë i gjuhës standarde maqedonase dhe shkrimit të saj cirilik në mjetet e komunikimit masiv, veçanërisht përmes mediumeve të regjistruara në Republikë, në pajtim me ligjin;

3. kujdes i zmadhuar shoqëror dhe individual për përdorimin e drejtë të gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik në komunikimin publik dhe zyrtar në Republikë;

4. shmangia e shprehjeve të huaja dhe huazimeve dhe zëvendësimi i tyre me terme përkatëse nga leksiku dhe frazeologjia maqedonase;

5. përkrahje në mësimin e gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik në institucione të huaja arsimore, në të gjitha shkallët e arsimit, nëpërmjet hapjes së lektorateve për gjuhë maqedonase jashtë shtetit, si dhe përkrahje për punën e lektoratëve ekzistuese jashtë shtetit;

6. detyrimisht të mësuarit e gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik në të gjitha shkallët e arsimit në Republikë dhe jashtë saj;

7. përdorimi i drejtë i gjuhës standarde maqedonase dhe shkrimit të saj cirilik në pushtetin legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv, si dhe në personat juridikë të themeluar me Kushtetutë dhe me ligj në komunikim të ndërsjellë;

8. stimulim dhe mbështetje të programeve dhe përmbajtjeve të mediave të regjistruara në Republikë, për përdorimin e gjuhës standarde maqedonase dhe shkrimit të saj cirilik, si dhe zhvillimin dhe përkthimin e interfejseve në gjuhën maqedonase për programet kompjuterike;

9. dhënia e bursave të studentëve për të mësuarit e gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik ;

10. krijimi i brezave të rinj për hulumtime shkencore të gjuhës maqedonase dhe shkrimit të saj cirilik;

11. ndarja e shpërblimeve shtetërore dhe mirënjohje nga sfera e studimit dhe afirmimit të gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik në Republikë dhe jashtë vendit;

12. përkrahje për mësimin e gjuhës së standardizuar maqedonase për studentë të huaj, të cilët gjuhën maqedonase e mësojnë si gjuhë të huaj, në dhe jashtë Republikës;

13. të mësuarit e gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik në qendrat kulturo-informative jashtë vendit;

14. të treguarit e mosrespektimeve gjuhësore dhe mënjanimi i parregullsive në përdorimin e gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik;

15. trajnime të vazhdueshme për përdorimin e drejtë të gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik për të punësuarit në: entet kulturore, edukative, arsimore, shkencore profesionale dhe institucione, administratën shtetërore dhe publike, gjykatat dhe mediat e regjistruara në Republikë;

16. organizimi i kurseve, seminareve, këshillimeve dhe aktiviteteve tjera të ndryshme për përdorimin e drejtë të gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik në Republikë dhe jashtë shtetit;

17. botimi i publik i librave në gjuhën maqedonase në Republikë dhe jashtë shtetit;

18. ndarje të mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për projekte në hulumtimet shkencore nga sfera e gjuhës maqedonase.

Neni 5

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut sjell Strategji nacionale për gjuhën maqedonase, me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e pas mendimit paraprak të Këshillit për Gjuhën Maqedonase për periudhë prej pesë viteve.

(2) Strategjia nacionale për gjuhën maqedonase (në tekstin vijues: Strategji nacionale) është dokument strategjik, me të cilin vërtetohen qëllime afatmesme dhe prioritete për zbatim, mbrojtje, avancimin dhe pasurimin e gjuhës së standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.

(3) Me Strategjinë nacionale vërtetohen masat organizative, financiare dhe administrative për realizimin e qëllimeve dhe prioriteteve.

(4) Strategjia nacionale përmban edhe plan aksionar për realizimin e saj, për periudhë prej pesë viteve, e në të cilën janë të definuar aktivitete, dinamikë, bartës të aktiviteteve dhe proekcioneve të mjeteve buxhetore dhe jashtë buxhetore, si dhe indikatorë për evaluimin e zbatimit të saj.

(5) Në përpunimin e Strategjisë Nacionale marrin pjesë ente të larta arsimore dhe shkencore, shoqata dhe ekspertë nga sfera e gjuhës maqedonase.

(6) Në procedurën për përpunimin e Strategjisë nacionale sigurohet pjesëmarrje e publikut të interesuar me mbajtjen e së paku një diskutimi.

(7) Ministritë dhe institucionet shkencore dhe profesionale, në kuadër të kompetencave të tyre ligjore, marrin pjesë në realizimin e Strategjisë nacionale.

(8) Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në nivel vjetor, detyrimisht sigurohen mjetet për realizimin e Strategjisë nacionale.

(9) Strategjia nacionale dorëzohet te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, së paku gjatë muaj para skadimit të plotfuqishmërisë së Strategjisë nacionale, paraprahe.

(10) Për realizimin e Strategjisë nacionale, Ministria e Kulturës njëherë në vit dorëzon raport te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për informim.

(11) Strategjia nacionale dhe raporti nga paragrafi (10) e këtij neni, në afat prej 30 ditëve nga dita e sjelljes së tyre shpallen në uebfaqen e Ministrisë së Kulturës.

(12) Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Këshillin e Gjuhës Maqedonase, nga neni 10, siguron kushte dhe kujdeset për zbatimin e Strategjisë nacionale.

Neni 6

(1) Gjuha e standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik detyrimisht përdoren në organet e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, në përfaqësitë diplomatiko-konzulare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shtete tjera dhe në organizata ndërkombëtare, në organet e njësisve të vetëqeverisjes lokale, në ente publike dhe institucione në persona të tjerë juridikë të themeluar me Kushtetutë dhe me ligj dhe në media të regjistruara në Republikë, në pajtim me ligj.

(2) Në ngjajrjet publike që organizohen në Republikë, e financohen me mjete nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, detyrimisht përdoret gjuha e standardizuar maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

(3) Përdoren në emërtimet e organeve nga paragrafi (1) i këtij neni, rrugicat, sheshet, urat dhe objektet tjera infrastrukturore, udhërrëfyesit, toponimet dhe shenjat e komunikacionit, emërtimet e përmendoreve memoriale dhe monumentet përkujtimore, si dhe në mbishkrimet në mjete për transport publik dhe në objektet publike.

(4) Në emërtimet nga paragrafi (3) i këtij neni, emërtimi në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik shënohet i parë, para emërtimit të gjuhës dhe alfabetit që e flasin së paku 20% nga qytetarët në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me së paku madhësi të njëjtë dhe font.

(5) Gjuha standarde maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik përdoren edhe në:

1. punën e ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të regjistruar në Republikë;
2. titrimi, pra dublimi i veprave audio dhe audiovizive në gjuhë të huaj që transmetohen ose ritransmetohen;
3. titrimi, gjegjësisht sinkronizimi i regjistrimeve në gjuhën maqedonase në të cilat nuk përdoret gjuha maqedonase dhe të cilat transmetohen me shtyrje.

(6) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë për Kulturë, e në bashkëpunim me Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës, me dekret i përshkruan fontet që mundësojnë paraqitjen përkatëse të shenjave të shkruara maqedonase në të gjitha format (standarde, e bolluar dhe pjerrtë), për përdorimin zyrtar të gjuhës maqedonase.

Neni 7

(1) Detyrimisht lekturohen në gjuhën e standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik:

1. Aktet e përgjithshme dhe të veçanta të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor të personave juridikë të krijuar me Kushtetutë dhe me ligj edhe të njësisve të vetëqeverisjes lokale, të cilat publikohen;

2. Dokumentet dhe tekstet zyrtare të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor të personave juridikë të krijuar me Kushtetutë dhe me ligj edhe të njësisve të vetëqeverisjes lokale të personave juridikë të krijuar me Kushtetutë dhe me ligj dhe të enteve publike dhe institucioneve nga sfera e kulturës, arsimit dhe shkencës që publikohen;

3. Kontratata ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

4. Titrimi, respektivisht sinkronizimi i veprave audio-vizuale dhe incizimeve që transmetohen ose ritransmetohen në mediet e regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me ligj;

5. Njoftime audio-vizuale komercial që emetohen në mediet e regjistruara në Republikë në pajtim me ligj;

6. Publikimet dhe librat që botohen në gjuhë të standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik;

7. Punimet e magjistraturës dhe doktoratës që janë të shkruara në gjuhë të standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe ata që përkthehen në gjuhë të standardizuar maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik nga gjuhë të huaja, në shpenzim të përpunuesit;

8. plakate, fletushka, prospekte, pankarta, billborde, reklama për vitrina ose lloj tjetër të materialit reklamues në formë fizike të personave juridikë;

9. Emërtimet e produkteve, ambalazheve, etiketave, udhëzimeve, deklaratave, certifikatave dhe ilaçeve;

10. Llogarive, faturave, fletëpagesave dhe vërtetimeve.

(2) Në tekstet nga paragrafi (1) i këtij neni emri i lektorit publikohet në mënyrë të përshtatshme, gjegjësisht lektura dokumentohet në mënyrë tjetër të përshtatshme, përveç në rastin nga paragrafi (1), pikat 6. dhe 7. të këtij neni kur në vetë botimin detyrimisht publikohet emri i lektorit, pra libër shkollor, respektivisht punim magjistrature, respektivisht doktorature.

Neni 8

(1) Gjatë regjistrimit të personit juridik në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut me detyrim zyrtar bën lektorimin e gjuhës së standardizuar maqedonase të emërimit të firmës dhe personit juridik.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse firma e personit juridik është e mbrojtur si markë tregtare, nuk kryhet lekturimi në gjuhën e standardizuar maqedonase.

(3) Në rastin nga paragrafi (2) i këtij neni, firma e personit juridik që është i mbrojtur si markë tregtare dhe është e shkruar në gjuhë tjetër, gjatë regjistrimit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, regjistrohet në mënyrë, në të cilën është e mbrojtur si markë tregtare, ndërsa në ndërtesën shtohet emërtimi në alfabetin cirilik, transkriptuar sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës maqedonase në fuqi.

Neni 9

Në organet nga neni 6, paragrafi 1 të këtij ligji, detyrimisht punësohen lektor nga gjuha maqedonase

Neni 10

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut themelon Këshill për Gjuhë Maqedonase si trup profesional këshill dhënës nga sfera e gjuhës maqedonase (në tekstin vijues: Këshilli).

(2) Këshilli është i përbërë nga kryetari dhe tetë anëtarë, me mandat prej katër viteve, me mundësi edhe të një mandati pasues.

(3) Kryetarin e Këshillit e emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë nga rendi i personave me emërtim të fituar shkencor doktor i shkencave nga sfera e gjuhës maqedonase.

(4) Anëtarët e Këshillit i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut edhe atë me propozim të kryetarit të Këshillit e me pëlqim paraprak nga ana e ministrit për kulturë dhe ministrit për arsim dhe shkencë.

(5) Së paku dy të tretat e Këshillit duhet të jenë doktorë të shkencave nga sfera e gjuhës maqedonase, ndërsa tjerët janë persona të shquar nga sfera e kulturës.

Neni 11

(1) Këshilli i kryen këto punë:

- e koordinon përgatitjen dhe jep mendim për Strategjinë nacionale;
- jep mendime, propozime, udhëzime dhe rekomandime për përdorimin, respektivisht përdorimin praktik, mbrojtjen, avancimin dhe pasurimi e gjuhës maqedonase, duke përfshirë edhe terminologjinë nga të gjitha fushat shkencore;
- Kujdeset për afirmimin e gjuhës maqedonase në të gjitha shkallët e arsimit;
- Kujdeset për afirmimin e gjuhës maqedonase në republikë dhe jashtë shtetit;
- propozon forma dhe zgjidhje për aplikim konsekuent, mbrojtje, promovim dhe pasurim të gjuhës maqedonase;
- Propozon programe për zbatimin, mbrojtje, avancimin dhe pasurimin e gjuhës maqedonase në të gjitha sferat e komunikimi zyrtar, që i dorëzon te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Kujdeset për zbatimin e dhe përsosmërinë e normës së gjuhës së standardizuar maqedonase;
- Vepron në fushën përkatëse të arsimit dhe kulturës gjuhësore;
- Bashkëpunon me institucione shkencore në Republikë dhe jashtë vendit;
- Boton publikime në gjuhën maqedonase dhe
- Kryen punë tjera nga sferat e nenit 4 të këtij ligji.

(2) Këshilli sjell program dhe rregullore për punën e tij.

(3) Këshilli njëherë në vit deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë dorëzon raport për punën e tij, për informim.

Neni 12

(1) Ministria e Arsimit dhe e Shkencës në maj të viti vijues shpall konkurs për bursë për nxënës nga klasa IV nga arsimi i mesëm për shkak të stimulimit të nxënësve për regjistrimin në universitet për mësimin e gjuhës maqedonase. Gjatë një viti mund të ndahen më pak 10, e më shumë 20 bursa.

(2) Ministria e Arsimit dhe e Shkencës gjatë vitit akademik shpall konkurs për bursa për studentë për mësimin e gjuhës maqedonase, në të tre ciklet e arsimit superior (në tekstin vijues: konkursi). Gjatë një viti mund të ndahen:

- Më pak 5, e më shumë 10 bursa për studime deridiplomike (cikli i parë);
- Së paku tre, e më shumë shtatë bursa për studime magjistrature (cikli idytë).
- Së paku dy, e më shumë pesë bursa për studime të doktoratës (cikli i tretë).

(3) Konkurset nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, shpallen në dy gazeta ditore që botohen në tërë territorin e Republikës, nga cilët njëri është në gjuhën maqedonase e tjetri në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare, e ndryshme nga gjuha maqedonase. Konkurset shpallen edhe në ueb faqen e Ministrisë për Arsim dhe Shkencë dhe zgjasin 30 ditë nga data e shpalljes.

(4) Vlerësimi i fletëparaqitjeve të dorëzuara në konkurset nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, kryejnë komisionet për përzgjedhje të kandidatëve, të formuara nga ana e ministrit të arsimit dhe shkencës.

(5) Komisionte nga paragrafi (4) i këtij neni janë të përbërë nga pesë anëtarë nga radha e të punësuarve, administratorë shtetërorë në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

(6) Ministri i Arsimit dhe i Shkencës me propozim të komisioneve nga paragrafi (4) i këtij neni, vendos për fletëparaqitjet nga konkurset në paragrafët (1) dhe (2) në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të konkurseve.

(7) Komisionet nga paragrafi (4) i këtij neni për punën e tyre, sjellin Rregullore për punë.

(8) Mënyra e realizimit të konkurseve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, i përshkruan ministri për Arsime dhe Shkencë.

Neni 13

(1) Lektorim, në pajtim me këtë ligj, është përmirësim drejtshkrimor, gramatikor, leksikor dhe stilistik dhe rregullimi i ndonjë teksti.

(2) Lektroimin e gjuhës maqedonase mund t'a bëjë person me provim të dhënë për marrjen e licencës për lektorim dhe me lincencë lektorimi të fituar në pajtim me këtë ligj.

Licencë lektorimi lëshon Ministria për Kulturë pas provimit të dhënë, në pajtim me këtë ligj.

(3) Lektor mund ta kryej veprimtarinë e tij edhe si profesion të lirë, në pajtim me rregullat e shoqatave tregtare.

Neni 14

(1) Provimin për marrjen e licencës për lektorim (në tekstin vijues: provimi për lektor) jepet për shkak të kontrollit të njohurive të nevojshme profesionale, aftësive dhe shkathtësive për kryerjen e lektorimit.

(2) Provimin për lektor mund t'a jep person, i cili ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK, ose ka të kryer VII/1 shkallë të arsimit superior në programet studimore gjuha maqedonase ose gjuhë maqedonase dhe letërsi, me lëndë të parë kryesore gjuhën maqedonase.

(3) Ministri i Kulturës, me propozim të Këshillit, formon komision për dhënien e provimit për lektor (në tekstin vijues: Komisioni). Komisioni është i përbërë nga kryetari dhe dy anëtarëve nga radhët e profesorëve universitarë nga sfera e gjuhës maqedonase, me mandat prej katër vitesh dhe me mundësi edhe për një mandat pasues.

(4) Mënyra e dhënies së provimit për lektor, programi për provim për lektor dhe pikat, me propozim të Këshillit, i shënon ministri i kulturës.

Neni 15

(1) Kërkesa për dhënien e provimit për lektor paraqitet në Ministrinë e Kulturës ose në formë elektronike duke përdorur mjetin e identifikimit elektronik nëpërmjet Portalit nacional për shërbimet elektronike, në përputhje me rregulloret nga fusha e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike dhe në fushën e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

(2) Me kërkesën për dhënien e provimit për lektor, kandidati është i detyruar të parashtrojë provë për plotësimin e kushteve nga neni 14, paragrafi (2) i këtij ligji.

(3) Kandidatëve që kanë dhënë provimin për lektor u dorëzohet licencë për lektorim në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të provimit për lektor.

(4) Kandidatëve që nuk e kanë kaluar provimin për lektor, Ministria e Kulturës u lëshon aktvendim në afat prej 15 ditëve nga dita e mbarimit të provimit për lektor.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (4) i këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ para një gjykate kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit.

(6) Aktvendimi nga paragrafi (2) i këtij neni mund të lëshohet edhe në formë elektronike në dokument elektronik që dorëzohet deri te profili i parashtruesit të kërkesës në portalin nacional për shërbime elektronike ose në një pikë për shërbime, në pajtim me rregullat nga sfera e administrimit elektronik dhe shërbimeve elektronike dhe nga sfera e dokumenteve elektronike dhe shërbimeve të besueshme.

(7) Formularin e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri i kulturës.

(8) Formën dhe përmbajtjen e licencës për lektor nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton ministri i kulturës.

Neni 16

- (1) Shpenzimet për dhënien e provimit për lektor janë në ngarkim të kandidatit.
- (2) Shpenzimet nga paragrafi (10) i këtij neni, i cakton ministri për kulturë në bazë të shpenzimeve reale për dhënien e provimit për lektor, të domosdoshme për zbatimin e provimit, për përgatitjen e materialeve, ftesave dhe licencave për lektor.
- (3) Shpenzimet për dhënien e provimit për lektor paguhen në llogarinë e Ministrisë së Kulturës.
- (4) Nëse shpenzimet nuk janë të paguara në llogari përkatëse të ministrisë për kulturë më vonë 15 ditë para ditës së caktuar për zbatimin e provimit për lektor, kandidatit nuk i lejohet dhënia e provimit.
- (5) Nëse kandidati në afat prej një viti nga pagesa e mjeteve nuk e kalon provimin për lektor, mjetet e paguara i kthehen në pajtim me ligj.

Neni 17

- (1) Licenca e lëshuar zëvendësohet me të re atëherë kur:
 - Për shkak të dëmtimit bëhet e papërdorshme;
 - Është e humbur ose në mënyrë tjetër bartësi i saj ka mbetur pa atë;
- (2) Në rastet nga paragrafi (1) nënparagrafi 1 të këtij neni, licenca paraprake e lëshuar për lektor lëshohet deri te Ministria për Kulturë për anulimin e saj, ndërsa bartësit i lëshohet licencë e re për lektor, më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit.
- (3) Për anulimin e licencës për lektor, ministri për kulturë formon komision tre anëtarësh nga radhët e të punësuarve në Ministrinë e Kulturës.
- (4) Bartësi i licencës për lektor që do t'a humbë licencën për lektor ose në mënyrë tjetër do të mbese pa të, është i detyruar t'a paraqesë në Ministrinë për Kulturë dhe të parashtrojë kërkesë për lëshimin e licencës së re për lektor në afat prej 15 ditëve deri te njoftimi për licencën e humbur.

Neni 18

- (1) Ministri për Kulturë, me propozim të Këshillit, me aktvendim do t'ai heqë licencën për lektor nëse bartësi i licencës lektorin në kundërshtim me standardet e shkruara për lektorim.
- (2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të ngrihet kontest administrativ para gjyqit kompetent në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.
- (3) Personit, të cilit i është marrë licenca për lektor, nuk ka të drejtë të jep provim për lektor në afat prej një viti nga dita e marrjes së licencës.

Neni 19

- (1) Licencat për lektor të lëshuara dhe të marrura, si dhe licencat për lektor që kanë pushuar të vlejné evidentohen në Regjistrin që e mban Ministria për Kulturë.
- (2) Regjistri nga paragrafi (1) i këtij neni publikohet në uebfaqen e Ministrisë së Kulturës.
- (3) Forma dhe përmbajtja e Regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni dhe mënyrën e mbajtjes së tij e shkruan ministri për Kulturë.

Neni 20

- (1) Punët profesionalo-administrative për Këshillin dhe për Komisionin i kryen Ministria për Kulturë.
- (2) Mjete për punën e Këshillit dhe për Komisionin sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit që kanë qenë prezent dhe kanë marrë pjesë në punën e seancës u takon kompensim që e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në varësi nga numri i seancave të mbajtura dhe nga vëllimi i ndërlikueshmërisë së punëve të kryera.

(4) Anëtarëve të Komisionit u takon kompensim që e përcakton ministri i Kulturës, në varësi të numrit të provimeve të mbajtura dhe të numrit të pyetjeve të përgatitura për provimin për lektor.

(5) Kryetari dhe anëtarët Këshillit dhe antarët e Komisionit dorëzojnë raport për punën e tyre njëherë2 në muaj, deri te minsitri për kulturë, në të cilin vërtetohen numri i senancave të realizuara dhe vëllimi dhe ndërlikueshmëria e punëve të kryera, respektivisht numri i provimeve të realizuara dhe numri i pyetjeve të përgatitura të provimit për lektor.

Neni 21

Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të sjellura në bazë të këtij ligji, bën Ministria për Kulturë.

Neni 22

(1) Punët e mbikëqyrjes së inspektimit mbi zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të sjellura në bazë të këtij ligj i kryejnë inspektorët për gjuhë maqedonase (Në tekstin vijues: inspektorët) e Inspektoratit për përdorimin e gjuhës së standardizuar maqedonase (në tekstin vijues: Inspektorati), si organ në përbërje të Ministrisë për Kulturë me vetinë e personit juridik.

(2) Inspektorati ka vetinë e personit juridik me llogari personale buxhetore si përdorues buxhetor i linjës së parë, në mënyrë të pavarur zbaton procedura për punësim në pajtim me ligj dhe vendos për të drejtat dhe obligimet për marrëdhënie pune.

(3) Në procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative, nëse me këtë ligj ndryshe nuk është rregulluar.

Neni 23

Për drejtor të Inspektoratit mund të jetë person i emëruar, i cili i plotëson kushtet vijuese:

(1) Të ketë shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

(2) Në momentin e emërimit me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor, nuk i është shqiptuar dënim burg ose sanksion shkelje ligji ndalesë për kryerje profesioni, veprimtari ose detyrim;

(3) Të ketë të fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose të ketë të mbaruar VII/1 shkallë arsim superior në programet studimore gjuhë maqedonase ose gjuhë maqedonase dhe letërsi, me lëndë të parë kryesore gjuhë maqedonase;

(4) Të ketë së paku gjashtë vjet përvojë pune pas diplomimit në sferën e gjuhës maqedonase;

(5) Të posedojë njërën nga certifikatat vijuese ndërkombëtare, të pranuar ose certifikata për njohjen aktive të gjuhës angleze, jo më të vjetër se pesë vite:

TOEFEL IBT – së paku 74 pikë,

- (IELTS) – së paku 6 pikë,

- (ILEC) (Cambridge English: Legal) – së paku ниво B2 (B2),

- (FCE) (Cambridge English: First) –i dhënë,

- (BULATS) –së paku 60pikëose

- (APTIS) – së paku (B2);

(6) Posedon vërtetim për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyra;

(7) posedon licencë për lektor.

Neni 24

(1) Drejtori i Inspektoratit:

1) e koordinon dhe organizon punën në Inspektorat;

- 2) E paraqet dhe përfaqëson Inspektoratin;
 - 3) Merr veprime juridike në emër dhe llogari të Inspektoratit;
 - 4) Siguron kushte për zbatimin efikas të ligjeve dhe të rregullave që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese;
 - 5) Vendos për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në Inspektorat;
 - 6) Siguron kushte për përsosje profesionale dhe për trajnim të specializuar të inspektorëve;
 - 7) Sjell akte për organizim të brendshëm dhe për sistematizimin e vendeve të punës në Inspektorat;
 - 8) Sjell dokumente programore dhe raportuese, duke përfshirë:
 - Plan strategjik inspektoratit,
 - Plan vjetor për punën e Inspektoratit
 - Program vjetor për trajnim të specializuar për inspektorët;
 - raport për punë të inspektoratit;
 - raport gjashtë mujor për punën e secilit inspektor;
 - plan mujor për secilin inspektor;
 - dokumente dhe akte tjera të parapara me ligj;
 - (9) sjell edhe akte tjera, për të cilat është i autorizuar;
 - (10) siguron transparencë në punën e Inspektoratit;
 - (11) kryen punë tjera nën kompetencën e Inspektoratit, në pajtim me ligj.
- (2) Në mungesë të drejtorit ose për shkak të sëmundjes ose shkaqe tjera ai nuk është në gjendje t'a kryejë funksionin, atë e zëvendëson një nga inspektorët udhëheqës për gjuhë maqedonase, i autorizuar nga drejtori, i cili i plotëson kushtet e nenit 23 të këtij ligji.

Neni 25

- (1) Kandidati për inspektor duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme për punësim të përcaktuara në Ligjin për Nëpunës Administrativë dhe kushte të posaçme për punësim për inspektor, të përcaktuara në Ligjin për Mbikëqyrje Inspektuese.
- (2) Për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhëniet e punës të inspektorëve, zbatohen dispozitat e Ligjit të Mbikëqyrjes Inspektuese, të Ligjit të Nëpunësve Administrativë dhe të Ligjit të të Punësuarve në Sektorin Publik.

Neni 26

Mbikëqyrja inspektuese kryhet me fletëurdhëresë të drejtorit ose në bazë të fletëurdhëresës së personit të autorizuar nga drejtori.

Neni 27

- (1) Inspektori në mënyrë të pavarur i kryen punët e inspektimit mbikëqyrës dhe merr masa, për të cilat është i autorizuar.
- (2) Gjatë kryerjes së inspektimit mbikëqyrës në pajtim me ligj, inspektori ka për detyrim:
- (1) të veprojë në bazë të iniciativave për ngritjen e procedurës inspektuese dhe për atë t'a informojë parashtruesin e iniciativës;
 - (2) T'a informojë personin përgjegjës të subjekti për mbikëqyrje për fillimin e mbikëqyrjes inspektuese, vetëm nëse me ligj ndryshe nuk është vërtetuar ose në njoftimin e tillë zvogëlohet efikasiteti i mbikëqyrjes;
 - (3) Të legjitimohet para subjektit të mbikëqyrjes, respektivisht para personit përgjegjës ose para personi tjetër të autorizuar të subjektit të mbikëqyrjes;
 - (4) Të hartojë procesverbal për mbikëqyrjen inspektuese ë kryer;
 - (5) Të veprojë ligjërisht, në kohë dhe në pajtim me kodeksin e etikës së nëpunësve shtetërorë dhe me kodeksin etik të shërbimit inspektues;

(6) T'a njoftojë personin përgjegjës të subjektit të mbikëqyrjes për bazën ligjore për kryerjen e mbikëqyrjes.

(3) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, Inspektorati ka të drejtë të kërkojë mendim përkatës nga Këshilli dhe Komisioni, se a është bërë lektorimi në pajtim me standardet e lektorimit.

Neni 28

(1) Inspektori nuk guxon të kryejë ose të jetë prezent në mbikëqyrje inspektuese mbi subjektin e mbikëqyrjes nëse ai ose anëtar i familjes së tij është pronar ose bashkëpronar, anëtar i organit të administrimit ose të organit mbikëqyrës ose ku ai ose anëtar i familjes së tij ka interes personal.

(2) Si anëtar i familjes nga paragrafi (1) i këtij neni, konsiderohet person që është në lidhje farefisnore gjaku në linjë të drejtë me inspektorin në pajtim me lig.

(3) Veprimet e marra në kundërshtim me paragrafin (1) të këtij neni konsiderohet si të asgjësuar dhe janë objekt i procedurës disiplinore.

Neni 29

(1) Mbikëqyrja inspektuese mund të jetë e zakonshme, jashtëzakonshme dhe kontrolluese.

(2) Subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i obliguar të bashkëpunojë dhe në kërkesë të inspektorit t'i mundësojë qasje të pandërprerë deri te hapësirat, dokumentet, sistemet elektronike, mjetet për komunikim ose te cili do çoftë mjet tjetër që është objekt i mbikëqyrjes inspektuese, si dhe t'a dorëzojë gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese.

Neni 30

(1) Për mbikëqyrjen inspektuese, gjendjen e vërtetuar faktike, parregullshmëritë konstatuara dhe të vërtetuara, vërejtje, deklarata dhe fakte tjera relevante dhe rrethana, inspektori harton procesverbal në vendin e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Procesverbalin nga paragrafi (1) i këtij neni e nënshkruajnë inspektori dhe subjekti i mbikëqyrjes inspektuese, të cilit i jepet një gjedhe. Nëse subjekti i mbikëqyrjes inspektuese refuzon t'a nënshkruajë procesverbalin, inspektori do t'i shënoje shkaqet e refuzimit.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (10) i këtij neni, kur për shkak të vëllimit dhe ndërlikueshmërisë së mbikëqyrjes inspektuese, natyrës së tij dhe rrethanave të punës nuk është e mundshme të hartohet procesverbal në vendin e kryerjes së mbikëqyrjes, procesverbali hartohet në hapësirat e inspektoratit në afat prej tre ditësh nga dita e mbikëqyrjes së kryer me arsyetim për shkaqet për të.

(4) Gjedhja nga procesverbali i paragrafit (3) të këtij neni, dorëzohet në nënshkrim deri te subjekti i mbikëqyrjes inspektuese. Nëse në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit, subjekti i mbikëqyrjes inspektuese nuk deklarohet në lidhje me procesverbalin e dorëzuar ose nuk e kthen të nënshkruar, konsiderohet se pajtohet me përmbajtjen e tij.

Neni 31

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori me aktvendim shqipton vërejtje dhe cakton afat, në të cilin subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i detyruar t'i mënjanojë parregullsitë që janë të vërtetuara me procesverbal.

(2) Nëse pas mbarimit të afatit të caktuar gjatë shqiptimit të vërejtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori vërtetoj se parregullsitë dhe mangësitë ende nuk janë të mënjanuara, me aktvendim shqipton masë tjetër inspektuese nëse është e përcaktuar me ligj të posaçëm, me të cilën në mënyrë më përkatëse do të arrihet qëllimi i mbikëqyrjes inspektuese.

(3) Aktvendimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, sillet menjëherë, e më vonë në afat prej 8 ditëve nga dita e përgatitjes së procesverbalit nga neni 30 i këtij ligji.

(4) Kur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nuk janë të vërtetuar parregullsi dhe shkelje tjera të ligjit ose ndonjë rregulle tjetër ose kur parregullsitë e vërtetuara janë të mënjanuara gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ose në afatin e përcaktuar me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori e ndalon procedurën me konstatim në procesverbalin të nenit 30 të këtij ligji.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (20) i këtij neni, inspektori mundet të shqiptojë masë inspektuese me aktvendim gojor i përmendur në procesverbalin nga neni 30 i këtij ligji.

(6) Në rastin e paragrafit (5) të këtij neni, inspektori është i detyruar menjëherë, e më vonë i përcaktuar në paragrafin (3) e këtij neni, të sjell aktvendim me shkrim për shqiptimin e masës inspektuese.

Neni 32

Kundër aktvendimit të inspektorit nga neni 31, paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni mund të deklarohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit deri te Komisioni Shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë të Inspektorati shtetëror administrativ.

Dispozitat ndëshkimore

Neni 33

(1) Gjobë në shumë prej 1500 deri 3000 eurosh, në kundërvlerë denarësh, do t'i shqiptohet për shkelje ligji personit juridik nëse:

- nuk e përdor gjuhën e standardizuar maqedonase në ngjarejt publike që organizohen në Republikë e financohen me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 6, paragrafi (2));

- Publikon akt të përgjithshëm ose të vetëm të pa lektuar (neni 7, paragrafi (1), pika 1);

- Emeton ose ri emeton titllim të pa lektuar ose sinkronizim i një vepre audio vizuale dhe njoftime audio vizuale (neni 7, paragrafi (1), pika 5);

- Boton publikim jo elektronik, respektivisht libër i pa lektuar (neni 7, paragrafi (1), pika 6);

- Nuk e lekturon punimin e magjistraturës ose punimin e doktoratës ose punimin e përkthyer (neni 7, paragrafi (21), pika 7);

- Shpall material reklamues të pa lektuar (neni 7, paragrafi (1), pika 8);

- Nuk i lekturon emërtimet e produkteve, ambalazheve, etiketave, udhëzimeve, deklaratave, certifikatave, barnave-ilaceve, fletëpagesave, e njësor (neni 7, paragrafi (1), pika 10);

- Nuk e shpall emrin e lektorit që ka kryer lektorimin (neni 7, paragrafi (2));

- Gjatë regjistrimit të personit juridik nuk kryen lektroimin e emërimit të firmës së personit juridik (neni 8, paragrafi (1));

- Nuk punon lektori për gjuhën maqedonase (neni 9)

- Me kërkesë të inspektorit nuk i mundësohet qasje të pandërprerë deri te dokumentet, sistemet elektronike, mjetet për komunikim ose cilit do çoftë mjet që është objekt i mbikëqyrjes inspektuese ose nuk e dorëzon dokumentacionin e plotë të nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes inspektuese (neni 29, paragrafi (2)).

(2) gjobë në shumë prej 750 deri 1500 në kundërvlerë denarësh do t'i shqiptohet për shkelje ligji nga paragrafi (1) i këtij ligji personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Për shkeljen e ligjit nga paragrafi (1) i këtij neni personit juridik mund t'i shqiptohet vërejte në pajtim me ligjin për Kundërvajtje.

(4) Gjobë prej 350 deri në 750 euro në kundërvlerë denarësh do t'i shqiptohet për shkelje ligji nga paragrafi (1), nënparagrafët 2, 6 dhe 7 të këtij neni, personit fizik.

(5) Për shkeljen e ligjit nga paragrafi (1) i këtij neni, personit fizik mund t'i shqiptohet vërejtje në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjeve.

Neni 34

(1) Gjobë në shumë prej 750 deri 1.500 euro në kundërvlerë denarësh do t'i shqiptohet personit juridik, nëse:

- Nuk e përdor gjuhën e standardizuar maqedonase (neni 6, paragrafi (1) dhe (5));
- Shpall dokument zyrtar të pa lekturuar ose tekst (neni 7, paragrafi (1) pika 2).

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri 750 euro në kundërvlerë denarësh do t' shqiptohet për shkeljen e ligjit nga paragrafi (1) i këtij neni, personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Për shkeljen e ligjit nga paragrafi 1 i këtij neni, personit juridik mund t'i shqiptohet vërejtje në pajtim me Ligjin për Kundërvajtje.

Neni 35

Për shkeljet e ligjit të neneve 33 dhe 34 të këtij ligji, procedurë kundërvajtëse dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

Neni 36

(1) Për shkeljet e ligjit të neneve 33 dhe 34 të këtij ligji, inspektori kryerësit të shkeljes së ligjit do t'i dorëzojë fletë urdhëresë për kundërvajtje për pagesë, në pajtim me Ligjin për Kundërvajtje.

(2) Formën dhe përmbajtja e fletë urdhëresës për kundërvajtje për pagesë nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri për kulturë.

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Neni 37

(1) Këshili për gjuhë maqedonase vazhdon me punë sipas dispozitave ligjore të këtij ligji deri në skadimi i mandatit të anëtarëve të tij.

(2) Komisioni për dhënien e provimit për lektor vazhdon me punë sipas dispozitave ligjore të këtij ligji deri në skadimi i mandatit të anëtarëve të tij.

Neni 38

(1) Procedurat për dhënien e provimit për lektor të filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të mbarojnë në pajtim me Ligjin për Përdorimin e gjuhës maqedonase ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/98, 89/08, 116/10, 187/13, 152/15, 192/15 dhe 193/17).

(2) Personave që kanë dhënë provimin për lektor në pajtim me dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhës maqedonase ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/98, 89/08, 116/10, 187/13, 152/15, 192/15 dhe 193/17) e deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk u është lëshuar licencë për lektor, provimi i dhënë për lektor u pranohet, u lëshohet licencë për lektor në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe regjistrohen në Regjistrin e nenit 19, paragrafit (1) të këtij ligji.

(3) Licencat për lektor të lëshuara në përputhje me Ligjin e Përdorimit të Gjuhës Maqedonase ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/98, 89/08, 116/10, 187/13, 152/15, 192/15 dhe 193/17), vazhdojnë të vlejnë në pajtim me këtë ligj.

Neni 39

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, do të sillen në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 40

(1) Drejtorin e Inspektoratit do t'a emërojë Qeveria e republikës së Maqedonisë në afat prej 3 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të publikojë shpallje publike për zgjedhjen e drejtorit të Inspektoratit.

(3) Inspektorati do të fillojë me punë me ditën e emërimit të drejtorit të Inspektoratit.

(4) Drejtori do t'i sjellë aktet për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës të Inspektoratit, më vonë 15 ditë na dita e emërimit të tij.

Neni 41

(1) Ligjet, në të cilat përmbahen dispozita për përdorimin e gjuhës së standardizuar maqedonase do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji, në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

(2) Organet nga neni 6, paragrafi (1) të këtij ligji, obligohen t'i zbatojnë obligimet nga neni 9 i këtij ligji në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Në rast të mospërputhjes ndërmjet dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave gjuhësore të ligjit tjetër, me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, organet nga neni 6 paragrafi (1) i këtij ligji janë të obliguar t'i zbatojnë dispozitat e këtij ligji.

Neni 42

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji i Përdorimit të Gjuhës Maqedonase ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 5/98, 89/08, 116/10, 187/13, 152/15, 192/15 dhe 193/17).

Neni 43

Dispozitat e neneve 22 deri në 32, të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga dita e fillimit me punë të Inspektoratit i Përdorimit të Gjuhës së Standardizuar Maqedonase.

Neni 44

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga shpallja në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.